



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 350/02-11735/26
Kaçanik, 29.05.2026

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (b), (c), (f) të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 4 paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 52/08 maj 2009), të nenit 6.2 (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut 01Nr. 350/02-11735/26 nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit prej datës 19.05.2026, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 maj 2026, mori këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJE NË INTERES PUBLIK
TË PARCELËS KADASTRALE NË ZK BOB

1. Me këtë Vendim, **SHPALLET** me interes publik prona e paluajtshme e parcelës kadastrale në **ZK BOB**, me pronësi private të personave fizik.

2. Sipas pikës 1. të këtij vendimi, shpallet me interes publik parcela e pronës, si vijon:

2.1 Parcela Kadastrale P-70917008-**00304-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S= 262 m^2$, në bashkëpronësi të personave me pjesë ideale prej 1/3, Afet Zeneli me numër personal [REDACTED], Nasur Zeneli me numër personal [REDACTED] dhe Feta Zeneli me numër personal [REDACTED], me vendndodhje në f. BOB, ZK Bob (shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $15.49 m^2$, e cila nevojitet për krijimin e një trotuari dhe një pjese të rrugës).

3. **Shpallja** e interesit publik të pronës së përcaktuar si në këtë vendim, bëhet me qëllim që kjo pronë të kalojnë në pronësi të komunës së Kaçanikut, pas një procedure të shpronësimit, për krijimin e një trotuari dhe një pjese të rrugës.

4. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, respektivisht 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL; Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni



*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning*

Për:	Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Përmes:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH
Nga:	Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në VL 112/26 MMPH
Zyrtarët përgjegjës:	
1.Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor	i Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e
2.Zyrtari hartues vlerësimit ligjor	i Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendim 01Nr.350/02-11735/26 për shpallje në interes publik të parcelës kadastrale në ZK Bob, miratuar në Kuvendin e Komunës së Kaçanikut

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 04.06.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 01Nr.350/02-11735/26 për shpallje në interes publik të parcelës kadastrale në ZK Bob, miratuar në Kuvendin e Komunës së Kacanikut

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave konstatoi se:

Prona e shpallur me interes publik sipas Vendimit 01Nr.350/02-11735/26 miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut është pronë private.

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-205, Komuna ka të drejtë të realizojë shpronësimin e pronave private brenda territorit të saj për zbatimin e projekteve në interes publik, të planifikuara sipas dokumenteve përkatëse. Rrjedhimisht, Komuna është vetë organi shpronësues.

Në rastin konkret, procedura e shpronësimit duhet të zhvillohet nga Kryetari i Komunës, ndërsa Departamenti i Shpronësimit nuk ka obligime në këtë procedurë dhe nuk duhet të përmendet në asnjë pjesë të vendimit. Procedura duhet të zhvillohet në përputhje me nenin 4, paragrafi 2 të ligjit përkatës, ndërsa nxjerrja e vendimeve duhet të bëhet në përputhje me nenet 8, 10 dhe 11 të po këtij ligji.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

